



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E ZBATIMIT REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NË 6-MUJORIN E PARË TË VITIT 2020” TË USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SH.A.

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NË 6-MUJORIN E PARË TË VITIT 2020” TË USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SH.A.

PËRMBAJTJA:

Nr.	PËRMBAJTJA	FAQJA
I.	Përmbledhje	3
	I/1. Hyrje	4
	I/2. Objektivat e auditimit	4
	I/3. Qëllimi i auditimit	4
	I/4. Metodologjia auditimit	4
	I/5. Konkulzione	4
II.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	4
III.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	4
	III/1. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimit të auditimit	5
IV.	Konkluzione dhe Rekomandime	13

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në Ujësjellës Kanalizime Fier SH.A. (UKF SH.A.) mbi: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2020”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2020;
- Hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, me personat përgjegjës dhe afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si: vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisione disiplinore për dhënien e masave disiplinore.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

Në përfundim të procesit të punës audituse në terren dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të paraqitura nga subjektet në fazën e Projekt Raport Auditimit, gjetjet e konstatuara të cilat janë reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, situata e zbatimit të rekomandimeve në 3 subjektet e audituara, paraqitet si vijon:

Nga ana e KLSH, me shkresat përcjellëse në auditimin e mëparshëm për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar 23 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 23 masa, ku nga të pranuarat janë zbatuar 6 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa, janë në proces zbatimi 5 masa organizative si dhe 10 masa organizative nuk janë zbatuar.

I/1 HYRJE

Auditimi u krye në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2, e nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr.1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Programit të Auditimit nr. 243, datë 11.02.2021 me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2020”.

Auditimi është kryer nga:

1. Erald Kojku (përgjegjës grupi)
2. Erieta Këlliçi, anëtar
3. Rodjan Alimerkaj, anëtar

- Çështjet e Audituara:

1. Hartimi i programit (Planit të veprimit), si dhe respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës, për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (shkronja “j” e nenit 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”).

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të Raportit Përfundimtar të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014).

2. Realizimi i rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë,

të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

3. Realizimi i rekomandimeve për *masa me karakter organizativ*, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

4. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

I/2 Objekti i auditimit IT:

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (terren) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, etj.

I/3 Qëllimi i auditimit IT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4 Metodologjia e auditimit:

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

I/5 Konkluzione

Nga përfundimi i punës në terren dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjekteve në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, rezulton se:

Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 23 masa, ku nga të pranuarat janë zbatuar 6 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa, janë në proces zbatimi 5 masa organizative si dhe 10 masa organizative nuk janë zbatuar.

II- Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Pavarësisht nga puna e bërë, ku niveli i realizimit të rekomandimeve është mbi 34%, për disa nga masat për të cilat janë në proces zbatimi ose nuk janë zbatuar duhet akoma më shumë punë për realizimin në nivelin 100% të rekomandimeve.

III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2020 – 30.06.2020.

Auditimi ka filluar më datë 12.02.2021

Auditimi ka përfunduar më datë 22.02.2021

III.1 Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

Nga ana e KLSH, me shkresën nr. 67/5 prot, datë 25.06.2020 për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar 23 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 23 masa, ku nga të pranuarat janë zbatuar 6 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa, janë në proces zbatimi 5 masa organizative si dhe 10 masa organizative nuk janë zbatuar.

III.1.1 Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

UKF SH.A. nuk ka kthyer përgjigje mbi hartimin e planit të veprimit për vënien në zbatim të rekomandimeve në respektim të afatit 20 ditë kalendarike, në kundërshtim me pikën 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Për mos raportimin në KLSH brenda afatit ligjor prej 20 ditësh, **mban përgjegjësi Administratori i Shoqërisë UKF SH.A., z. PN.**

III.1.2 Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit).

UKF SH.A. nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Për mos raportimin në KLSH brenda afatit ligjor prej 6 muajsh, **mban përgjegjësi Administratori i Shoqërisë UKF SH.A., z. PN.**

III.1.3 Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

Nga te pranuarat	Nr.	%
Zbatuar	6	26
Zbatuar pjesërisht	2	9
Ne proces	5	22
Nuk jane zbatuar	10	43

Nga ana e KLSH me shkresën nr. 67/5 prot, datë 25.06.2020, për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 23 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 23 masa, ku nga të pranuarat janë zbatuar 6 masa ose 26%, janë zbatuar pjesërisht 2 masa ose 9%, janë në proces zbatimi 5 masa organizative ose 22% si dhe 10 masa organizative nuk janë zbatuar ose 43%.

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga KLSH i janë rekomanduar UKF SH.A, 23 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 23 masa. Nga masat e pranuar janë zbatuar 6 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa, janë në proces zbatimi 5 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 10 masa organizative.

Më hollësisht, auditimi i zbatimit të rekomandimeve:

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. nuk ka Strategji për Teknologjinë e Informacionit, mungesa e të cilës sjell mos pasqyrimin e objektivave lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme si dhe instrumenteve të nevojshëm për matjen e objektivave. Mungesa e Planit Strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A.

1.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A., duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

1.2 Nga auditimi rezulton që: Janë marrë iniciativa për hartimin e Strategjisë së Teknologjisë së Informacionit por nuk ka ndonjë dokument të miratuar.

Rekomandimi është në proces

2. Gjetje nga Auditimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A nuk ka politika mbi sigurinë dhe Vazhdueshmërisë së Punës së Institucionit. Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A dhe nuk ka krijuar kushtet e nevojshme për vënien në dispozicion rregulloreve të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit me qëllim që të gjithë punonjësit të familjarizohen dhe ta bëjnë pjesë të mënyrës së të menduarit dhe të veprimtarisë së tyre të përditshme.

2.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A., të marrin masa për hartimin e dokumenteve të nevojshme për mirëfunksionimin dhe vazhdimësinë e punës pa ndërprerje në institucion si dhe njohjen me rregulloret dhe politikat TIK ekzistuese të të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit.

2.2 Nga auditimi rezulton që: Janë marrë iniciativa për hartimin e dokumenteve të nevojshme për mirëfunksionimin dhe vazhdimësinë e punës pa ndërprerje në institucion por nuk janë të miratuara nga strukturat përgjegjëse.

Rekomandimi është në proces

3. Gjetje nga Auditimi: Struktura IT nuk ka një bazë rregullative të plotësuar (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, dokumentacion mbi procedurat e backup, dokumentacion mbi procedurat e veprimeve në sistem etj.).

3.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. të marrin masa për hartimin dhe miratimin e bazës rregullative të Teknologjisë së Informacionit (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve t, dokumentacion mbi procedurat e backup etj.).

3.2 Nga auditimi rezulton që: Nuk ekziston bazë rregullative (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, dokumentacion mbi procedurat e backup, dokumentacion mbi procedurat e veprimeve në sistem etj.).

Rekomandimi nuk është zbatuar

4. Gjetje nga Auditimi: Nuk ka plan trajnimi vjetor për burimet njerëzore të sektorit të Teknologjisë e Informacionit. Nga ana e burimeve njerëzore dhe Sektorit të Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Trajnimet e përfituara nga donatorët dhe zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.

4.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve IT si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

4.2 Nga auditimi rezulton që: Nuk dokumentohet plan mbi identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT, por trajnimet faktohen nga certifikatat e trajnimit të vëna në dispozicion nga Përgjegjësi i IT.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

5. Gjetje nga Auditimi: Organizimi i strukturës IT-së nën Sektorin e Burimeve Njerëzore, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. duke zbehur ndikimin e varësisë direkt nga menaxhimi i lartë.

5.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. të analizojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore të strukturës ekzistuese IT me qëllim rritjen e rolit të saj në mbarëvajtjen e punës dhe sistemeve në UKF SH.A.

5.2 Nga auditimi rezulton që: Përgjegjësi i IT vazhdon të jetë nën varësinë e Burimeve Njerëzore.

Rekomandimi nuk është zbatuar

6. Gjetje nga Auditimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. ka regjistër risku për teknologjinë e informacionit të pa miratuar dhe në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik

6.1. Gjetje nga Auditimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohet mbi bazë ngjarjesh.

Jepet suport, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit. Procedurat kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve, duke mos realizuar identifikimin e risqeve, mbart riskun e përsëritjes së incidenteve. Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

6.2. Gjetje nga Auditimi: Nuk dokumentohet procesi i hapjes dhe mbylljes së përdoruesve në sisteme

6.3. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. të marrin masa për hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregullave për:

- a) identifikimin e risqeve IT dhe hartimin e regjistrit të risqeve.
- b) dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve.

- c) menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.
- d) miratimin e regjistrit të riskut.

6.4 Nga auditimi rezulton që: Janë ndërmarrë hapa për hartimin e rregulloreve për identifikimin e risqeve IT, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve, menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre si dhe për regjistrin e riskut.

Rekomandimi është në proces zbatimi

7. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procesit të identifikimit të nevojave për investime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe priorizimit të tyre konstatohet se Struktura e IT-së nuk është përfshirë në procesin e identifikimit të nevojave si dhe nuk përfshihet në procesin e menaxhimit të tyre.

7.1. Rekomandimi: Ujësjiellës Kanalizime Fier SH.A. të rishikojë pozicionimin e strukturës IT afër qeverisjes me qëllim kryerjen e analizimit, prioritarizimit dhe planifikimit të nevojave për sistemet e reja dhe ekzistuese të Teknologjisë së Informacionit në të ardhmen si dhe të marri masa për rritjen e bashkëveprimit ndër-institucional në përputhje me politikat dhe strategjitë për parashikimin dhe koordinimit të investimit në fushën e IT.

7.2 Nga auditimi rezulton që: Në procedurat e prokurimit me bazë Teknologjinë e Informacionit gjendet kërkesa mbi nevojat për pajisje TIK si dhe përgjegjësi i TI është anëtarë i komisionit të ngritur me urdhër të titullarit për specifikimet teknike.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

8. Gjetje nga Auditimi: Për katër nga pesë kontratat të cilat përmenden në raportin përfundimtar mungon numri i protokollit si dhe në shumë raste gjatë dokumentimit të procedurave mungon gjithashtu dhe data e realizimit të dokumentacionit, gjë e cila nuk jep siguri të arsyeshme gjatë punës audituese për vërtetësinë e dokumenteve.

8.1. Rekomandimi: Ujësjiellës Kanalizime Fier SH.A. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen, për të gjithë dokumentacionin mbështetës të procedurave të prokurimit të shënohen numrat e protokollit dhe data e realizimit si dhe çdo plotësim i nevojshëm sipas dokumenteve standarde të prokurimeve publike.

8.2 Nga auditimi rezulton që: në verifikimin e procedurave të kryera pas lënies së rekomandimit është shënuar numri i protokollit dhe data e realizimit në dokumentacionin mbështetës të procedurave të prokurimit.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

9. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i tre kontratave të Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (MNSH) respektivisht kontratën me objekt “Shërbim mirëmbajtje AL-Billing” me fitues operatorin ekonomik “JS” Sh.p.k., kontratën me objekt “Shërbim Interneti LAN TO LAN për Nevojat e SH.A UKF” me fitues operatorin ekonomik “TA” sh.p.k. dhe kontratën me objekt “Shërbim Printim Faturash” me fitues Operatorin Ekonomik “IA” sh.p.k., nuk ka të bashkëngjitur kontratën e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (MNSH) si një aneks i kontratës administrative, të lidhur ndërmjet palëve në kundërshtim me pikën nr.6 të Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

9.1. Rekomandimi: Ujësjiellës Kanalizime Fier SH.A. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të marri masa:- Për të gjitha procedurat e prokurimit me bazë Marrëveshjen në Nivel Shërbimi (MNSH), të marrë masa që kontratave administrative të prokurimeve me bazë teknologjinë e informacionit, t’ju bashkëngjisë si aneks kontratën e Marrëveshjes në Nivel Shërbimi MNSH-në, pra të hartojë dhe zbatojë Marrëveshje të Nivelit të Shërbimit sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

9.2 Nga auditimi rezulton që: janë bashkangjitur aneks kontratat e Marrëveshjes në Nivel Shërbimi për kontratën me objekt “Shërbim Interneti LAN TO LAN për Nevojat e SH.A UKF” me fitues operatorin ekonomik “A” SH.A. dhe për dhe kontratën me objekt “Shërbim Printim Faturash” me fitues Operatorin Ekonomik “IA” sh.p.k.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

10. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i tre kontratave të Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (MNSH) kontratën me objekt “Shërbim mirëmbajtje AL-Billing” me fitues operatorin ekonomik “JS” Sh.p.k., kontratën me objekt “Shërbim Interneti LAN TO LAN për Nevojat e SH.A. UKF” me fitues operatorin ekonomik “TA” sh.p.k. dhe kontratën me objekt “Shërbim Printim Faturash” me fitues Operatorin Ekonomik “IA” sh.p.k, ka mangësi në procesin e vlerësimit të shërbimit (Kolaudimin) kur dihet që përfundimi i implementimit të çdo projekti, shoqërohet me kolaudime të pjesshme ose me një analizë kosto-përfitim (matja e cilësisë së shërbimit) sipas udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2013 “Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për et TIK në Administratën Publike” pjesa III pika 10 Aneksi 2 dhe sipas pikës 8 (ç) të Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

10.1. Rekomandimi: Ujështetues Kanalizime Fier SH.A. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të marrë masa:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit, të marrë masa përkatëse për ngritjen e një grupi pune që të bëjë të mundur shoqërimin me kolaudime të pjesshme ose me një analizë kosto-përfitim të shërbimeve të përfituara për të bërë një vlerësim efikas mbi cilësinë dhe garantimin e vazhdueshmërisë së shërbimeve.

10.2 Nga auditimi rezulton që: nuk është ngritur asnjë grup pune që të bëjë të mundur shoqërimin me kolaudime të pjesshme ose me një analizë kosto-përfitim të shërbimeve të përfituara për të bërë një vlerësim efikas mbi cilësinë dhe garantimin e vazhdueshmërisë së shërbimeve.

Rekomandimi nuk është zbatuar

11. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave IT, nuk janë përcaktuar personat përgjegjës ose **personat e kontaktit** për AK dhe OE, mbi marrjen në dorëzim të projekteve IT, me qëllim ndjekjen dhe mbarëvajtjen e shërbimit të kërkuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2013 “Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për et TIK në Administratën Publike” pjesa III pika 10 Aneksi 2 dhe sipas pikës 8 (dh) të Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

11.1. Rekomandimi: Ujështetues Kanalizime Fier SH.A. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të marrë masa:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit, të marrë masa për përcaktimin e hallkave përkatëse të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për zbatimin dhe mbarëvajtjen e shërbimeve duke dokumentuar procesin monitorues.

Nga auditimi rezulton që: Nuk dokumentohet caktimi i personave përgjegjës ose personat e kontaktit për marrjen në dorëzim të projekteve IT.

Rekomandimi nuk është zbatuar

12. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i kontratës me objekt “Shërbim mirëmbajtje AL-Billing” me fitues operatorin ekonomik “JS” Sh.p.k., u konstatua se kohëzgjatja e kësaj MNSH-je nuk është hartuar në përputhje të plotë me VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe

funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” pika 2, paragrafi b.

12.1. Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marri masa:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit të marrë masat e nevojshme për përcaktimin e elementëve të nevojshëm në përputhje me kërkesat mbi zbatimin e Marrëveshjeve e Nivelit të Shërbimit sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

12.2 Nga auditimi rezulton që: *nuk është zhvilluar procedurë prokurimi me objekt “Shërbim mirëmbajtje AL-Billing” për vitin 2021.*

Rekomandimi është në proces zbatimi

13. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i konstatua se Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. kryen backup-in e bazës së të dhënave në të njëjtin ambient me bazën e të dhënave primare (*dhoma e serverëve*).

13.1. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. të marrin masat e nevojshme për krijimin e kushteve të përshtatshme për realizimin e procesit të backup-in sipas standardeve më të mira mbi ruajtjen e të dhënave.

13.2 Nga auditimi rezulton që: *Nuk janë marrë masa mbi krijimin e kushteve të përshtatshme për realizimin e backup-it sipas standardeve më të mira mbi ruajtjen e të dhënave.*

Rekomandimi nuk është zbatuar

14. Gjetje nga Auditimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. nuk ka kryer analizë risku lidhur me Sigurinë e të dhënave, identifikimin e të dhënave kritike si dhe kërcënimet e mundshme në ndikim të sistemeve, aplikacioneve ku zhvillohet aktiviteti i UKF SH.A.

14.1. Gjetje nga Auditimi: Siguria e infrastrukturës network në Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A është e kompromentuar si rezultat i mungesës së:

- a. Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e user-ave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendërzuat të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet;
- b. Firewall Hardware;
- c. Switch të menaxhueshëm.

14.2. Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A të marrë masat e nevojshme me qëllim rritjen e sigurisë në infrastrukturën network duke analizuar, prioritarizuar, identifikuar dhe planifikuar nevojat e institucionit.

14.3 Nga auditimi rezulton që: *nuk ka kryer analizë risku lidhur me Sigurinë e të dhënave, identifikimin e të dhënave kritike si dhe kërcënimet e mundshme në ndikim të sistemeve, aplikacioneve ku zhvillohet aktiviteti i UKF SH.A.*

Rekomandimi nuk është zbatuar

15. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se dhënia dhe ndalimi i aksesit të informacionit për përdoruesit e sistemeve (punonjës të brendshëm, të jashtëm, të larguar nga puna apo punonjës të transferuar) nuk shoqërohet me një dokumentacion për të dokumentuar dhe administruar këta përdorues. Krijimi dhe fshirja e përdoruesve bëhet verbalisht nga administruesit e programeve përkatës.

15.1. Gjetje nga Auditimi: UKF SH.A. nuk ka procedura për të përcaktuar akseset dhe privilegjet e përdoruesve në mënyrë që përdorimi i informacionit të jetë në përputhje me nivelin dhe pozicionin e punës, duke qenë se programet janë ndërtuar mbi arkitekturën “*multirole dhe multiuser*” duke ofruar mundësinë e krijimit apo aksesit të informacionit në sisteme.

15.2. Rekomandimi: UKF SH.A. të marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave për krijimin dhe fshirjen e përdoruesve, ndarjen e duhur të roleve në sisteme për aksesin në informacion, në mënyrë që të dokumentohet gjurma e auditimit.

15.3 Nga auditimi rezulton që: *nuk ekziston rregullore dhe procedurë e dokumentuar mbi krijimin dhe fshirjen e përdoruesve, ndarjen e duhur të roleve në sisteme për aksesin në informacion, në mënyrë që të dokumentohet gjurma e auditimit.*

Rekomandimi nuk është zbatuar

16. Gjetje nga Auditimi: Nuk kryhen ndryshime sistematike të fjalëkalimeve (*minimalisht 60 ditë*), e përcaktuar dhe në manualin e përdorimit të programit Al-Billing, në mënyrë që ruajtja e të dhënave të jetë më e sigurt duke ulur mundësinë e hyrjeve të paautorizuara në të dhënat e sistemit.

16.1. Rekomandimi: UKF SH.A. të marrë masa për përmirësimin në mënyrë sistematike të procesit të vendosjes së fjalëkalimeve me qëllim rritjen e sigurisë së aksesit.

16.2 Nga auditimi rezulton që: *pas lënies së rekomandimit është marrë parasysh nga kompania që të kryejë ndryshimet sistematike të fjalëkalimeve mbi përdoruesit për një periudhë brenda 6 muajve.*

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

17. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se deklarata e konfidencialitetit për përgjegjësinë dhe mbrojtjen e informacionit sensitiv, nuk përkon me datën e fillimit të punës së punonjësve që kanë akses në të dhënat e sistemeve, në kundërshtim me ligjin nr. 9987, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave Personale*” i ndryshuar.

17.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese në UKF SH.A. të marrin masa për monitorimin e dhënies së aksesit në sistemet e UKF SH.A. , vetëm të punonjësve të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, mbi informacionet sensitive.

17.2 Nga auditimi rezulton që: *deklaratat e konfidencialitetit për përgjegjësinë dhe mbrojtjen e informacionit sensitiv gjenden në dosjet e punonjësve që kanë akses në të dhënat e sistemeve.*

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

18. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se UKF SH.A. nuk ka kryer (*për periudhën nën auditim 01.01.2019-31.12.2019*) procedurat për miratimin e faturës tatimore duke lejuar gjenerimin nga sistemi “Al Billing” të faturave me TVSH pa kod fiskal.

18.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Fier SH.A. të marrin masa për miratimin e faturave tatimore të gjeneruara nga sistemi “Al Billing”.

18.2 Nga auditimi rezulton që: *i janë drejtuar me kërkesë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier me kërkesë nr. Prot 352 datë 03.06.2020 për lëshim diapazoni numrash serial dhe është implementuar në sistemin e faturimit “Al Billing”.*

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

19. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se në sistemin e faturimit “Al Billing” janë kryer veprime për sistemime duke gjeneruar 53 dublikata në fushën “Numri Serial” për të cilat nuk mbahet dokumentacion për argumentimin e tyre.

19.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Fier SH.A. të marrin masa për të mos krijuar dublikate. UKF SH.A. duhet të dokumentojë çdo proces pune mbi ndryshimet dhe sistemimet në sisteme.

19.2 Nga auditimi rezulton që: vazhdojnë të ekzistojnë dublikatat në sistemin e faturimit.

Rekomandimi nuk është zbatuar

20. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Faturimit “Al Billing” për periudhën 01 janar 2019 deri më 31 dhjetor 2019 rezulton se janë kryer veprime duke krijuar 94,970,256 “Hendeqe” në fushën ID. Ky rezultat tregon se të dhënat kur hidhen në sistem nuk marrin numrin e ID inkrimentale, si pasojë jep mundësinë për ndryshimin e të dhënave në sistem dhe s’ të jep mundësinë e ndjekjes së një rrjedhje historike të faturave që nga krijimi, modifikimin final ose dhe deri në fshirjen e tyre.

20.1. Rekomandimi Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Fier SH.A. të marrin masa për analizimin e situatës së krijuar në lidhje me “Hendeqet” në fushën ID, duke e vendosur atë si fushë automatike dhe inkrementale, me qëllim krijimin e sigurisë së arsyeshme të gjurmës së auditimit të të dhënave të sistemit “Al-Billing”.

Nga auditimi rezulton që: vazhdojnë të ekzistojnë dublikatat në sistemin e faturimit.

Rekomandimi nuk është zbatuar

21. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se UKF SH.A. nuk ka hartuar rregullore apo udhëzime mbi veprimet operationale në Sistemin e Faturimit “Al Billing” për parametrizime të ndryshme të sistemit apo dhe hapat që duhen ndjekur në rastin e anulimit/ndryshimit të rekordeve në bazën e të dhënave. Manuali i Sistemin e Faturimit “Al Billing” është i pa përditësuar.

21.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Fier SH.A. të marrin masa për hartimin dhe miratimin e bazës rregullatore të Sistemit të Faturimit “Al Billing” dhe përditësimin e manualit të përdorimit të sistemit.

Nga auditimi rezulton që: ekzistojnë draft rregulloret mbi Sistemin e Faturimit “Al Billing” por nuk janë të miratuara.

Zbatim i rekomandimit është në proces zbatimi

22. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se popullimi i programit “Web-GIS, i kontraktuar me qëllim menaxhimit e aseteve, është në nivel të ulët, duke mos përfunduar identifikimin, pasqyrimin e aseteve të të gjithë pjesëve përbërëse të rrjetit të akumulimit dhe të shpërndarjes së ujit në UKF SH.A. Të dhënat rreth stacioneve të pompimit, linjave, puseve, depove nuk janë regjistruar. Duke qenë se popullimi i aseteve nuk është bërë, programi nuk mund të gjenerojë raporte, për vendndodhjen e këtyre aseteve për menaxheret, punonjësit e ujësjellësit, ashtu dhe për vizitorët (qytetarët).

22.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të UKF SH.A. të marrin masa për analizimin e gjendjes dhe hartimin e një plan veprimi për vënien në efikasitet të programit Web-Gis, të kryhet regjistrimi sistematik i aseteve dhe rezultatet të jenë të aksesueshme në përputhje me qëllimin e sistemit.

22.2 Nga auditimi rezulton që: janë ndërmarrë hapa mbi popullimit e programit Web-Gis por nuk është hartuar ndonjë plan veprimi mbi vënien në efikasitet të programit.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

23. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me praktikën më të mira si dhe standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI përkatësisht:

e. Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit.

Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit

Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dyshemë

f. Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.

d. Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

23.1. Rekomandimi: Ujësjetës Kanalizime Fier Sh. A. të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomave të serverave në përputhje me praktikën më të mira si dhe standardet e përcaktuara në bazë të standardeve TIK dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Nga auditimi rezulton që: nuk është kryer ndërhyrje mbi ndërtimin e dhomës së Serverave sipas standardeve më të mira.

Rekomandimi nuk është zbatuar

Përmbledhëse e Masave Organizative

Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
MASA ORGANIZATIVE	23	23	6	2	5	10

Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Drejtuesi i Shoqërisë së Ujësjetës Kanalizime Fier sh.a., z. PN.

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi rezulton se UKF SH.A. ka zbatuar plotësisht 6 rekomandime, pjesërisht 2 rekomandime, në proces zbatimi 5 rekomandime dhe 10 rekomandime pa zbatuar.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **ri kërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nuk ka plan trajnimi vjetor për burimet njerëzore të sektorit të Teknologjisë e Informacionit. Nga ana e burimeve njerëzore dhe Sektorit të Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Trajnimet e përfituara nga donatorët dhe zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.

1.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Ujësjetës Kanalizime Fier SH.A. të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve IT si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se popullimi i programit “Web-GIS, i kontraktuar me qëllim menaxhimit e aseteve, është në nivel të ulët, duke mos përfunduar identifikimin, pasqyrimin e aseteve të të gjithë pjesëve përbërëse të rrjetit të akumulimit dhe të shpërndarjes së ujit në UKF SH.AA. Të dhënat rreth stacioneve të pompimit, linjave, puseve, depove nuk janë regjistruar. Duke qenë se popullimi i aseteve nuk është bërë, programi nuk mund të gjenerojë raporte, për vendndodhjen e këtyre aseteve për menaxheret, punonjësit e ujësjellësit, ashtu dhe për vizitorët (*qytetarët*).

2.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të UKF SH.A. të marrin masa për analizimin e gjendjes dhe hartimin e një plan veprimi për vënien në efikasitet të programit Web-Gis, të kryhet regjistrimi sistematik i aseteve dhe rezultatet të jenë të aksesueshme në përputhje me qëllimin e sistemit.

Në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Struktura IT nuk ka një bazë rregullative të plotësuar (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, dokumentacion mbi procedurat e backup, dokumentacion mbi procedurat e veprimeve në sistem etj.).

3.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Fier SH.A. të marrin masa për hartimin dhe miratimin e bazës rregullative të Teknologjisë së Informacionit (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve t, dokumentacion mbi procedurat e backup etj.).

Menjëherë

4. Gjetje nga Auditimi: Organizimi i strukturës IT-së nën Sektorin e Burimeve Njerëzore, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në Ujësjellës Kanalizime Fier SH.A. duke zbehur ndikimin e varësisë direkt nga menaxhimi i lartë.

4.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Ujësjellës Kanalizime Fier SH.A. të analizojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore të strukturës ekzistuese IT me qëllim rritjen e rolit të saj në mbarëvajtjen e punës dhe sistemeve në UKF SH.A.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i tre kontratave të Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (MNSH) kontratën me objekt “*Shërbim mirëmbajtje AL-Billing*” me fitues operatorin ekonomik “JS” Sh.p.k., kontratën me objekt “*Shërbim Interneti LAN TO LAN për Nevojat e SH.A. UKF*” me fitues operatorin ekonomik “TA” sh.p.k. dhe kontratën me objekt “*Shërbim Printim Faturash*” me fitues Operatorin Ekonomik “IAI” sh.p.k, ka mangësi në procesin e vlerësimit të shërbimit (*Kolaudimin*) kur dihet që përfundimi i implementimit të çdo projekti, shoqërohet me kolaudime të pjesshme ose me një analizë kosto-përfitim (*matja e cilësisë së shërbimit*) sipas udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2013 “*Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për et TIK në Administratën Publike*” pjesa III pika 10 Aneksi 2 dhe sipas pikës 8 (ç) të Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 “*Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit*”.

5.1. Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime Fier SH.A. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të marri masa:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit, të marrë masa përkatëse për ngritjen e një grupi pune që të bëjë të mundur shoqërimin me kolaudime të pjesshme ose me një analizë kosto-përfitim të shërbimeve të përfituara për të bërë një vlerësim efikas mbi cilësinë dhe garantimin e vazhdueshmërisë së shërbimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave IT, nuk janë përcaktuar personat përgjegjës ose *personat e kontaktit* për AK dhe OE, mbi marrjen në dorëzim të projekteve IT, me qëllim ndjekjen dhe mbarëvajtjen e shërbimit të kërkuar sipas përcaktimeve të *Udhëzimit nr. 2*, datë 02.09.2013 “*Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për et TIK në Administratën Publike*” *pjesa III pika 10 Aneksi 2* dhe sipas *pikës 8 (dh)* të Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 “*Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit*”..

6.1. Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të marri masa:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit, të marrë masa për përcaktimin e hallkave përkatëse të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për zbatimin dhe mbarëvajtjen e shërbimeve duke dokumentuar procesin monitorues.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i konstatua se Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. kryen backup-in e bazës së të dhënave në të njëjtin ambient me bazën e të dhënave primare (*dhoma e serverëve*).

7.1. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. të marrin masat e nevojshme për krijimin e kushteve të përshtatshme për realizimin e procesit të backup-in sipas standardeve më të mira mbi ruajtjen e të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga Auditimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. nuk ka kryer analizë rrisht lidhur me Sigurinë e të dhënave, identifikimin e të dhënave kritike si dhe kërcënimet e mundshme në ndikim të sistemeve, aplikacioneve ku zhvillohet aktiviteti i UKF SH.A.

8.1. Gjetje nga Auditimi: Siguria e infrastrukturës network në Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A është e kompromentuar si rezultat i mungesës së:

- a. Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e user-ave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qëndrësuar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet;
- d. Fireëall Hardwre;
- e. Switch të menaxhueshëm.

8.2. Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A të marrë masat e nevojshme me qëllim rritjen e sigurisë në infrastrukturën network duke analizuar, prioritarizuar, identifikuar dhe planifikuar nevojat e institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se dhënia dhe ndalimi i aksesit të informacionit për përdoruesit e sistemeve (punonjës të brendshëm, të jashtëm, të larguar nga puna apo punonjës të transferuar) nuk shoqërohet me një dokumentacion për të dokumentuar dhe administruar këta përdorues. Krijimi dhe fshirja e përdoruesve bëhet verbalisht nga administruesit e programeve përkatës.

9.1. Gjetje nga Auditimi: UKF SH.A. nuk ka procedura për të përcaktuar akseset dhe privilegjet e përdoruesve në mënyrë që përdorimi i informacionit të jetë në përputhje me nivelin dhe pozicionin e punës, duke qenë se programet janë ndërtoar mbi arkitekturën “*multirole* dhe *multiuser*” duke ofruar mundësinë e krijimit apo aksesit të informacionit në sisteme.

9.2. Rekomandimi: UKF SH.A. të marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave për krijimin dhe fshirjen e përdoruesve, ndarjen e duhur të roleve në sisteme për aksesin në informacion, në mënyrë që të dokumentohet gjurma e auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se në sistemin e faturimit “Al Billing” janë kryer veprime për sistemime duke gjeneruar 53 dublikata në fushën “Numri Serial” për të cilat nuk mbahet dokumentacion për argumentimin e tyre.

10.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. të marrin masa për të mos krijuar dublikate. UKF SH.A. duhet të dokumentojë çdo proces pune mbi ndryshimet dhe sistemimet në sisteme.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Faturimit “Al Billing” për periudhën 01 janar 2019 deri më 31 dhjetor 2019 rezulton se janë kryer veprime duke krijuar 94,970,256 “Hendeqe” në fushën ID. Ky rezultat tregon se të dhënat kur hidhen në sistem nuk marrin numrin e ID inkrimentale, si pasojë jep mundësinë për ndryshimin e të dhënave në sistem dhe s’ të jep mundësinë e ndjekjes së një rrjedhje historike të faturave që nga krijimi, modifikimin final ose dhe deri në fshirjen e tyre.

11.1. Rekomandimi Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. të marrin masa për analizimin e situatës së krijuar në lidhje me “Hendeqet” në fushën ID, duke e vendosur atë si fushë automatike dhe inkrementale, me qëllim krijimin e sigurisë së arsyeshme të gjurmës së auditimit të të dhënave të sistemit “Al-Billing”.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me praktikën më të mira si dhe standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI përkatësisht:

e. Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit.

Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit

Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme

f. Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.

d. Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

12.1. Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A. të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomave të serverave në përputhje me praktikën më të mira si dhe standardet e përcaktuara në bazë të standardeve TIK dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. nuk ka Strategji për Teknologjinë e Informacionit, mungesa e të cilës sjell mos pasqyrimin e objektivave lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme si dhe instrumenteve të nevojshëm për matjen e objektivave. Mungesa e Planit Strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A.

13.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A., duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga Auditimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A nuk ka politika mbi sigurinë dhe Vazhdueshmërisë së Punës së Institucionit. Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A dhe nuk ka krijuar kushtet e nevojshme për vënien në dispozicion rregulloreve të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e

informacionit me qëllim që të gjithë punonjësit të familjarizohen dhe ta bëjnë pjesë të mënyrës së të menduarit dhe të veprimtarisë së tyre të përditshme.

14.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A., të marrin masa për hartimin e dokumenteve të nevojshme për mirëfunksionimin dhe vazhdimësinë e punës pa ndërprerje në institucion si dhe njohjen me rregulloret dhe politikat TIK ekzistuese të të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit.

Menjëherë

15. Gjetje nga Auditimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. ka regjistër rrishtu për teknologjinë e informacionit të pa miratuar dhe në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik

15.1. Gjetje nga Auditimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, në mungesë të procedurave të shkruara, rrishtet menaxhohet mbi bazë ngjarjesh.

Jepet suport, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit. Procedurat kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve, duke mos realizuar identifikimin e rrishteve, mbart rrishtun e përsëritjes së incidenteve. Identifikimi i rrishteve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

15.2. Gjetje nga Auditimi: Nuk dokumentohet procesi i hapjes dhe mbylljes së përdoruesve në sisteme

15.3. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. të marrin masa për hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregullave për:

- a) identifikimin e rrishteve IT dhe hartimin e regjistrit të rrishteve.
- b) dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve.
- c) menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.
- d) miratimin e regjistrit të rrishtit.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i kontratës me objekt “Shërbim mirëmbajtje AL-Billing” me fitues operatorin ekonomik “J” Sh.p.k., u konstatua se kohëzgjatja e kësaj MNSH-je nuk është hartuar në përputhje të plotë me VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” pika 2, paragrafi b.

16.1. Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marri masa:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit të marrë masat e nevojshme për përcaktimin e elementëve të nevojshëm në përputhje me kërkesat mbi zbatimin e Marrëveshjeve e Nivelit të Shërbimit sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se UKF SH.A. nuk ka hartuar rregullore apo udhëzime mbi veprimet operacionale në Sistemin e Faturimit “Al Billing” për parametrizime të ndryshme të sistemit apo dhe hapat që duhen ndjekur në rastin e anulimit/ndryshimit të rekordeve në bazën e të dhënave. Manuali i Sistemin e Faturimit “Al Billing” është i pa përditësuar.

17.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A. të marrin masa për hartimin dhe miratimin e bazës rregullatore të Sistemit të Faturimit “Al Billing” dhe përditësimin e manualit të përdorimit të sistemit.

Shënim: Ju lutemi, merrni masat që Raporti i Auditimit, t'ju komunikohet të gjithë personave të interesuar të përmendur në të, në mënyrë që të kenë mundësinë, të paraqesin brenda afatit komentet dhe shpjegimet e tyre.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT